



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
GJUHË E FOLUR DHE E SHKRUAR

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë 40 seminare

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet:: viti I, semestri I

Lloji i lëndës: lëndë me zgjedhje

Programi i studimit: Bachelor – Gjuhë letërsi dhe qytetërim grek

Kodi i etikës” Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: studentët do të zhvillojnë aftësitë gjuhësore për t'iu përgjigjur situatave dhe strukturave gjuhësore të drejtpërdrejta dhe të tërthorta (me gojë ose me shkrim); do të njihen me rregullat shoqërore gjuhësore dhe jo-gjuhësore; do të njihen me karakteristikat themelore të kulturës greke.

Objektivat specifike lëndore: a) gjuhë e folur - studentët do të zhvillojnë aftësitë për të kuptuar pikat kryesore, por edhe disa detaje thelbësore në një fjalim të zhvilluar që ka të bëjë me çështje të njohura në lidhje me punën, arsimin, argëtimin etj.; studentët do të kenë aftësinë të kuptojnë, të përfshihen në biseda me folës natyrorë dhe të përgjigjen në fusha tematike si: njoftime ose informacione publike, reklama në programe televizive dhe radio, udhëzime nga punonjësit e shërbimeve të ndryshme, tregime dhe përshkrime të ngjarjeve, njerëzve, objekteve, hapësirave, ngjarje aktuale ose çështje të interesit personal/ profesional, arsimit, koha e lirë, udhëtimet, mallrat e konsumit, marrëdhëniet shoqërore etj.; b) gjuhë e shkruar - studentët do të zhvillojnë aftësitë për të kuptuar kuptimin e përgjithshëm dhe detajet thelbësore të teksteve të shkruara dhe aftësinë e të shkrimit në lidhje me situatat e komunikimit në fusha tematike si: manuali i përdorimit të pajisjeve të ndryshme, tabelat dhe sinjalet e trafikut, programet televizive, radiofonike, artistike, broshura dhe fletëpalosje, artikuj në gazeta dhe revista, aplikime për punësim, korrespondenca formale dhe personale, shërbimet publike etj.; studentët do të njohin dhe do të përdorin në mënyrë korrekte rregullat themelore të drejtshkrimit.